- 25. Procedura e ankesës** 1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.  
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës** 1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.  
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:  
a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;  
b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;  
c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;  
d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;  
e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;  
Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.  
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Shërbimeve .....	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....	
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)	



**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

(a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

(b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

(c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

Shërbimi	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Njësia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim
1	Tarifa për çdo ndërhyrje (si për mirëmbajtjen e planifikuar ashtu edhe për mirëmbajtjen e paplanifikuar)	24	nderhyrje		
2	Normë orësh për Ekipin (2 teknikë) në vendin e punës për mirëmbajtje të jashtëzakonshme (vetëm për aktivitete të paplanifikuara që zgjasin përtej ditës në të cilën u krye ndërhyrja e parë)	200	orë		
3	Kontakt per dyer	20	copë		
4	Susta dyersh	20	copë		
5	Rrula per dyer	20	copë		
6	Patina per dyer	20	copë		
7	Butona	20	copë		
8	Llampa ndriçimi per kabinen	20	copë		
9	Bateri 12V 9Ah	20	copë		
10	Impulsor	20	copë		
11	Çeles fundor	20	copë		
12	Kontaktor	20	copë		
13	UPS per evakuimin emergjent	1	copë		
14	Skeda qendrore	1	copë		

15	Rip dere	6	copë		
16	Kavo dere	4	copë		
17	Ventilator kabine	1	copë		
<b>Çmimi total (Shërbimet) pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë _____</b>					

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

## Shtojca 4

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtjesit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

## Shtojca 5

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 6**

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen për çdo kontratë:**

<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>
1	Tarifa për çdo ndërhyrje (si për mirëmbajtjen e planifikuar ashtu edhe për mirëmbajtjen e paplanifikuar)
2	Normë orësh për Ekipin (2 teknikë) në vendin e punës për mirëmbajtje të jashtëzakonshme (vetëm për aktivitete të paplanifikuara që zgjasin përtej ditës në të cilën u krye ndërhyrja e parë)
3	Kontakt për dyer
4	Susta dyersh
5	Rrula për dyer
6	Patina për dyer
7	Butona
8	Llampa ndriçimi për kabinën
9	Bateri 12V 9Ah
10	Impulsor
11	Çeles fundor
12	Kontaktor
13	UPS për evakuimin emergjent
14	Skeda qendrore
15	Rip dëre
16	Kavo dëre
17	Ventilator kabine

**Afatet e ekzekutimit të kontratave:** Sipas nevojave të AK.

**Shtojca 7**

**MIRËMBAJTJA E ASHENSORIT NË STACIONIN E KOMPRESORIT FIER**

**TERMAT E REFERENCES DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**



## TREGUESI

1. QËLLIMI I TERMAVE TE REFERENCES DHE SPECIFIKIMIVE TEKNIKE .....
2. KONTEKSTI.....
3. PËRSHKRIM I MIRËMBAJTJEVE TË KËRKUARA.....
4. RAPORTET E MIRËMBAJTJES.....
5. PJESËT REZERVË.....
6. EKZEKUTIMI I MIRËMBAJTJES NË NDËRTESAT E TAP .....
7. HSE.....
8. GARANCITË DHE DETYRIMET E KONTRAKTUESIT .....
9. ANEKSET .....

## 1. QËLLIMI I TERMAVE TE REFERENCES DHE SPECIFIKIMIVE TEKNIKE

Në Stacionin e Kompresorit TAP në Fier (Seman), në ndërtesën e administratës është instaluar një ashensor (1 kat) për transport personash. Ashensori duhet të mirëmbahet çdo muaj në mënyrë që të sigurojë funksionimin normal, të sigurtë të pajisjeve në përputhje me parametrat e projektimit dhe gjithashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi (DCM Nr. 1056, datë 23.12.2015 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES TEKNIKE "PËR SIGURINË E ASHENSORËVE NË PËRDORIM").

Gjithashtu kjo kërkesë vjen nga perfaqësuesit e TAP si pasojë e zbatimit të kontratës TAP-AGS dhe planin vjetor të mirëmbajtjes.

Ky dokument përcakton fushën e punës dhe veprimtaritë teknike të mirëmbajtjes që do të kryen nga kontraktori. Ai rregullon gjithashtu marrëdhëniet e punësimit që do të ekzistojnë midis kompanisë AGSCo dhe Kontraktorit.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për sigurimin se ky Specifikim Teknik zbatohet plotësisht nga të gjithë perfaqësuesit e tij.

Kohëzgjatja e kontratës është e barabartë me 2 (dy) vjet nga data e nënshkrimit të saj.

Lloji i kontratës do të jetë një Marrëveshje Kuadër.

## 2. KONTEKSTI

Pas marrëveshjeve të nënshkruara midis TAP dhe autoriteteve shqiptare, Snam Spa (Operatori Italian i Sistemit të Transmetimit) dhe Albgaz (Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit), kanë ngritur një ndërmarrje të përbashkët të quajtur AGSCo (Albanian Gas Service Company Sh.A.), për ekzekutimin e mirëmbajtjes në pasuritë e TAP në Shqipëri.

### AKRONIME DHE PËRKUFIZIME

ACS03	Albania Stacioni i Kompresorit 03. Ndodhet në Fier.
HSE	Shëndeti, siguria dhe mjedisi.
TAP	Trans Adriatic Pipeline.
AGSCo	Albania Gas Service Company.
PPE	Pajisje për mbrojtje personale.
PTW	Leje për punë.
Kontratë	Kontrata e mirëmbajtjes dhe shërbimeve për objektin e këtij specifikimi teknik.
Kontraktues	Kontraktori që do të kryejë mirëmbajtjen e ashensorit.
OEM	Prodhues origjinal pajisjesh
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

## PËRSHKRIM I OBJEKTEVE TË MBULUARA NGA KONTRATA

Vendndodhja e stacionit të kompresorit Fier është:

Objektet TAP	Pozicioni GPS	
ACS03 - Stacioni i Kompresorit Fier	Gjerësia: Gjatësia:	40.791871°
Seman - Fier		19.453191°

Të dhënat teknike të ashensorit janë:

TECHNICAL DATA/TË DHËNAT TEKNIKE	
ELEVATOR TYPE	: ELECTRIC MRL TYPE
LLOJI I ASHENSORIT	: TIP ELEKTRIK MRL
TYPE OF LIFT	: PASSENGER
LLOJI I NGARKESËS	: PASAGJERË
RATED LOAD	: 600 kg - 8 PERSONS
SASIA E NGARKESËS	: 600 kg - 8 PERSONA
NO. OF STOPS	: 2
NUMRI I NDALESAVE	: 2
TRAVEL HEIGHT	: 3.70m
LARTESIA E LËVIZJES	: 3.70m
SHAFT DIAMENTIONS	: 2.10m x 1.55
DIMENSIONET E PUSIT	: 2.10m x 1.55
CABIN DIAMENTIONS	: 1.40m x 1.10m
DIMENSIONET E KABINËS	: 1.40m x 1.10m
CABIN SPEED	: 0.75 m/sec
SHPEJTËSIA E KABINËS	: 0.75 m/sec
CABIN DOORS	: AUTOMATIC SLIDING DOORS 0.90x2.10m
DYERT E KABINËS	: DYER TË RRËSHQITSHME AUTOMATIKE 0.90x2.10m
ENGINE POWER	: 4.5kW
FUQIA E MOTORRIT	: 4.5kW
FIRE FIGHTERS ELEVATOR	: NO
ASHENSOR KUNDRA ZJARRIT	: JO

Vizatimet e ashensorit janë në aneksin 1.

### 3. PËRSHKRIM I MIRËMBAJTJEVE TË KËRKUARA

#### 3.1 MIRËMBAJTJE E PLANIFIKUAR.

Ndërhyrjet e planifikuara të mirëmbajtjes do të kryhen nga Kontraktori në një bazë mujore duke përdorur personelin të kualifikuar. Gjithashtu të konsumueshmet e nevojshme për realizimin e shërbimit duhet të sigurohen nga Furnizuesi.

Mirëmbajtja mujore e planifikuar e ashensorit do të përfshijë kontrollet e mëposhtme të përbërësve kryesorë të ashensorit:

Niveli i dyshemesë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrolli i saktësisë së ndalimit (me garancitë e dhëna)</li> </ul>
---------------------	--

Krahu i urgjencës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll operativ</li> </ul>
Treguesit e uljes së ashensorit dhe kontrollit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll operativ</li> </ul>
Kabina e ashensorit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll operativ</li> <li>• Kontrolli i ndriçimit emergjent, butonatçelësat</li> </ul>
Hyrjet në dysheme:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kabllot, zinxhiri ose kontrolli i rripit</li> <li>• Duke kontrolluar të çarat e dyerve</li> <li>• Kontrolli i udhëzuesve të derës</li> <li>• Kontrolli i derës për operim të lirë</li> </ul>
Dera e kabinës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i derës për operim të lirë</li> <li>• Kontrolli i udhëzuesve të derës</li> <li>• Duke kontrolluar të çarat e dyerve</li> <li>• Kontrolli i lubrifikuesve</li> <li>• Kontrolli i zgavrës metalike, i katenave ose i rripit kur aplikohet</li> <li>• Kontrolli i funksionit të sensorit ose perdes së dritës</li> <li>• Regjistrimi i derës dhe lubrifikuesi për të siguruar funksionimin normal (nëse është e nevojshme)</li> </ul>
Zona e grumbullit:34	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolloni I për të gjithë komponentët e pastër dhe të lirë nga korrozioni / depërmation.</li> <li>• Kontrolli i dritës CTIV (në rastet kur ka)34</li> <li>• Kontrolli i vajit të tepërt në fund të shinave, rrjedhjet</li> <li>• Kontrolloni nëse pusi është i pastër, i thatë.</li> </ul>
Absorbuesi i goditjes:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolllo gjendjen e tyre funksionale</li> </ul>
Pajisjet e sigurisë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i çelësit</li> <li>• Kontrolli operacional dhe distanca nga binarët</li> <li>• Kontroll lubrifikues (kur është e nevojshme)</li> <li>• Kontrolli i lidhjeve elektrike/mekanike/instrumentale</li> <li>• Kontrolloni pjesët për lëvizje dhe konsum të lirë.</li> </ul>
Kabineti (korniza) e kabinës, pula:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll lubrifikues (kur është e nevojshme)</li> <li>• Kontrolli i gjendjes së përgjithshme</li> <li>• Kontrolli i pajisjeve rrëshqitëse për konsum të lartë</li> </ul>
Kabllot / zinxhirët:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i lubrifikuesve</li> <li>• Kontrolli për konsumin, kohëzgjatjen dhe tensionin e kavos.</li> <li>• Kontrolli i konsumatorit në pikat kavo-link</li> </ul>
Udhëzuesi i Kompjuterit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Duke kontrolluar lubrifikimin në sipërfaqen aktive të shinave 34</li> <li>• Kontrolli i kapjes/ankorimit, bashkohu (nëse aplikohet)</li> </ul>

Kontrolli i mbikalimit të shpejtësisë (rregullatori me mbikalim) (nëse aplikohet):	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i pjesëve për lëvizje të lirë dhe konsum të mundshëm</li> <li>• Kontroll operativ</li> <li>• Kontrolli i çelësit</li> </ul>
Çelësat e fundit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i funksionimit të çelësave të poshtëm</li> </ul>
Sistemet elektrike dhe UPS:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i izolimit dhe instalimi korrekt i lidhjeve elektrike</li> <li>• UPS dhe Kontrolli i Funksionimit të Baterive</li> </ul>
Gjenerator (nëse aplikohet):	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolllo kuisjet për zhurmë të pazakontë ose dridhje</li> <li>• Kontrolllo gjendjen e çelësit</li> </ul>
Panelet:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i pastrimit dhe funksionimit normal</li> </ul>
Limitues i kohës së motorit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll operativ</li> </ul>
Pajisjet e sigurisë elektrike:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli elektrik i funksionimit</li> <li>• Kontroll sigurie</li> </ul>
Pajisje kundër rrëshqitjes:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli operacional (kur është e nevojshme)</li> </ul>
Kutia e shpejtësisë (nëse aplikohet):	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll për konsum të mundshëm</li> <li>• Kontrolli i lubrifikuesve</li> </ul>
Ekstraktim elektrik:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i shtetit dhe shkalla e konsumit</li> </ul>
Pajisje dhe çelësa kundër reaksionit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll për lëvizjen dhe funksionimin e lirë</li> <li>• Kontrolllo të njëjtin tension kabllor</li> <li>• Kontrolllo çelësin aty ku është e nevojshme</li> <li>• Kontrolli i lubrifikuesve</li> </ul>
Frena:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i sistemit të frenave</li> <li>• Kontrolli i të konsumueshmeve</li> <li>• Kontrolli i saktësisë së ndalimit</li> </ul>
Pastrim për ndarjen e kablllove kryesore:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolllo situatën dhe kanalet për çdo konsumim</li> <li>• Kontrolllo kuisjet për zhurmë të pazakontë ose dridhje</li> <li>• Kontrolli i pjesëve mbrojtëse</li> <li>• Kontrolli i lubrifikuesve</li> </ul>

Të konsumueshmet për ekzekutimin e ndërhyrjeve periodike të planifikuara të mirëmbajtjes do të sigurohen nga kontraktori (operatori ekonomik) dhe kostot lidhur me to do të përfshihen brenda koston së shërbimit.

Për të kryer shërbimin, kontraktori duhet të garantojë disponueshmërinë e mjeteve të nevojshme. Të gjitha mjetet duhet të përputhen me standardet ndërkombëtare, të kalibrohen dhe të kenë një certifikatë të vlefshme kalibrimi.

Mirëmbajtja e planifikuar duhet të kryhet sipas Termave të referencës/specifikimeve teknike dhe ndërhyrjet duhet të garantohen sipas kërkesave të AK.

Kontraktori do të jetë autonom në kryerjen e veprimtarive në fushën e kontratës.

### 3.2 MIRËMBAJTJE E PAPANIFIKUAR

Ndërhyrjet shtesë të paplanifikuara të mirëmbajtjes mund të kërkohen, nga AGS sha, përveç atyre të përshkruara në seksionin 3.1. Normalisht do të kërkohet me e-mail nga AGS sha. Në kërkesë AGS sha do të specifikojë:

- Lloji i ndërhyrjes (ndërhyrje e jashtëzakonshme ose urgjente);
- Çdo kontroll dhe /ose riparim i sistemit të kërkuar.

Kontraktori merre persiper te mbuloje te gjitha shpenzimet qw do te bejw pwr realizimin e kwtij shwrbimi, perfshire transportin, mobilizimin etj.

Për të kryer shërbimin, kontraktori duhet të garantojë disponueshmërinë e pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme. Të gjitha pajisjet dhe mjetet duhet të përputhen me standardet ndërkombëtare, të certifikuara, dhe të kenë një certifikatë të vlefshme kalibrimi.

#### MIRËMBAJTJE E JASHTËZAKONSHME E PAPANIFIKUAR

Kontraktori duhet të ekzekutojë ndërhyrjen brenda një kohe maksimale prej 2 ditësh pune nga data e kërkesës dhe në çdo kohë të vitit.

Në qoftë se kërkesa bëhet të premtën, të shtunat dhe të dielat nuk do të përfshihet në numërim.

#### MIRËMBAJTJE URGJENTE E PAPANIFIKUAR

Ne rastin e kesaj nderhyrje, kontraktori duhet të ekzekutojë ndërhyrjen në vend brenda një kohe maksimale prej 4 orësh nga kërkesa e marrë me telefon dhe në çdo kohë të vitit duke përfshirë pushimet.

### 3.3 24/7 DISPONUESHMËRIA

Kontraktori duhet të garantojë, nëpërmjet qendrës së tij të operacioneve, një shërbim disponueshmërie 24/7 (24 orë në ditë, 7 ditë në javë). Numri i telefonit të urgjencës duhet të vendoset brenda dhe jashtë ashensorit.

## 4. RAPORTET E MIRËMBAJTJES

Raportet e mirmbajtjes/ndërhyrjet e planifikuara të mirëmbajtjes duhet të paraqiten në përputhje me formatin në aneksin 3 (raporti i mirëmbajtjes periodike).

Për ndërhyrjet e paplanifikuara të mirëmbajtjes, Kontraktori mund të përdorë formatin e tij standard të raportit, por kontraktori duhet të sigurohet që informacioni minimal i mëposhtëm të jetë i përfshirë:

- Data dhe ora e fillimit dhe përfundimit të ndërhyrjes
- Përshkrimi i problemeve të hasura
- Përshkrimi i veprimtarive të kryera në përgjigje të ndërhyrjes së jashtëzakonshme
- Analiza e shkakut të rrjedhës
- Emrat e stafit të përfshirë
- Fletët e kohës të nënshkruara nga kontraktori dhe AGSCo
- Lista e pajisjeve/veglave të përdorura

- Lista e të konsumueshmeve dhe rezervës së përdorur për ndërhyrjen

Raportet do të dërgohen brenda 2 ditë pune pas çdo ndërhyrje dhe ajo duhet të nënshkruhet si nga kontraktori ashtu edhe nga Përfaqësuesi i AGSCo dhe do të dorëzohet pranë AGSCo.

## 5. PJESËT REZERVË

Kontraktori duhet të garantojë disponueshmërinë e të paktën pjesëve rezervë të pershkruara në oferten ekonomike.

Kontraktori do të zëvendësojë pjesët e dëmtuara duke përdorur pjesë rezervë origjinale, qw i pwrshaten brandit të ashensorit. Nevoja për zëvendësimin e pjesëve duhet të autorizohen nga AGSCo.

## 6. EKZEKUTIMI I MIRËMBAJTJES NË NDËRTESAT E TAP

### 6.1 AKTIVIZIMI I SHËRBIMIT, HYRJA NË MJEDISËT E TAP

Të gjitha ndërhyrjet e mirëmbajtjes do të kërkohen nga AGSCo e cila do të aktivizojë Kontraktorin nëpërmjet menyrave të përcaktuara midis Palëve. Hyrja e kontraktorit në Stacionin e Kompresoreve Seman ACS03 do të lejohet vetëm në prani të një përfaqësuesi të AGSCo që do të ofrojë ndihmë teknike dhe administrative .

Kontraktori duhet të japë emrat e teknikëve paraprakisht për arsye sigurie minimalisht 1 (nje) jave përpara ndrhyrjes. Teknikët do tu kërkohet për të bërë një trajnim fillestar mbi sigurinë dhe shëndetin në punë në mbërritje në mjediset e Stacionit.

### 6.2 PËRPILIMI I PTW

Hyrja në mjediset e Stacionit lejohet vetëm pas përfundimit dhe autorizimit të lejes së punës (PTW Permit to Work). Përgjegjësia për plotësimin e PTW është e AGSo. Kontraktori është përgjegjës për të dhënat e siguruar dhe të futura në PTW në lidhje me llojin e punës që do të kryhet dhe kompetencën e personelit të punësuar.

Gjithashtu me PTW do të vendosen të dhëna mbi paisjet që do të përdoren, risqet e mundshme etj.

## 7. HSE

Kontraktori duhet të respektojë të gjitha kërkesat e ligjit Shqiptar, me referencë të veçantë, por jo të kufizuar në:

- Legjislacioni Shqiptar i zbatueshëm për veprimtarinë e mirëmbajtjes/inspektimit të ashensorëve
- Ligji për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin;
- Kuadri rregullator i mbetjeve në Shqipëri;

Për më tepër, kontraktori duhet të jetë në përputhje me:

- pjesa e AGSCo-STD-001 'AGSCo HSE Standardet minimale për kontraktorët' (dhe ndryshimet e mëvonshme) që janë të zbatueshme për aktivitetet e saj dhe që ofrohen së bashku me këtë fushë shërbimesh (aneks 2);
- Politikat e AGSCo dhe klientit të AGSCo kur aktiviteti mbahet në mjediset e Klientit.

Te gjitha procedurat per HSE duhet te vihen ne dispozicion pas shpalljes se operatorit fitues ne tender. Keto procedura jane te detyrueshme per tu vene ne dispozicion perpara fillimit te aktivitetit ne terren nga Operatori ekonomik fitues.

Përveç të gjitha veprimeve që kërkohen për të respektuar ligjet shqiptare, **kontraktorit i kërkohet të përgatit përpara fillimit të aktiviteve**, një plan specifik i SHSM (HSE) për t'u koordinuar me atë të AGSco që përmban masat në fuqi për të trajtuar rreziqet shëndetësore, të sigurisë dhe mjedisit që lidhen me kryerjen e këtyre Shërbimeve. Përveç asaj që është deklaruar brenda AGSco-STD-001, Plani HSE duhet:

- të përcaktojë veprimet që duhen ndërmarrë për të kontrolluar këto rreziqe në një nivel të pranueshëm;
- të përmbajnë një listë të të gjithë personelit të trajnuar dhe kompetent të angazhuar në kryerjen e punës;
- të përshkruajë se si do të zbatohen dispozitat e AGSco dhe AGSco Client në të gjithë zinxhirin e nënkontraktimeve, nëse do të ketë ndonjë nënkontraktor;
- të përcaktojë organizimin dhe përgjegjësitë e QHSE-së;
- të përcaktojë se si do të menaxhohen aspektet mjedisore.

Kontraktorit mund t'i kërkohet të mbikqyrë treguesit specifik të performancës në bazë mujore, sipas një formati dhe periodiciteti që do të bihet dakord.

OE kur shpallet fitues duhet të:

Përgatisë Planin për Shëndetin Dhe Sigurinë në Punë dhe Dokumentin e Vlerësimit të Riskut në përputhje me kërkesat e legjisllacionit shqiptar.

## 7.1 RREGULLAT E SJELLJES BRENDË MJEDISEVE TË KLIENTËVE AGSCO OSE AGSCO

I gjithë personeli i Kontraktorit do të zbatojë rregullat e sjelljes që janë vendosur brenda mjediseve të TAP dhe AGSco nëpërmjet planeve, procedurave, udhëzimeve të punës, standardeve, komunikimeve dhe materialeve informative.

Nëse ndonjë nga personeli i kontraktuesit gjendet në shkelje ndaj rregullave të përmendura më sipër, AGSco ka të drejtën t'i kërkojë kontraktorit ta zëvendësojë me efekt të menjëhershëm punonjësin.

Në veçanti, i gjithë personeli do të përdorë PPE-në që është identifikuar brenda Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut të Kontraktorit dhe Planit të SHSM sipas AGSco-STD-001 'AGSco HSE Standardet minimale për kontraktorët'.

## 7.2 TRAJNIMI

Në lidhje me trajnimin, dispozitat e përgjithshme të deklaruara nga AGSco-STD-001 konsiderohen të vlefshme dhe Kontraktori është përgjegjës për të siguruar kompetencat e personelit të vet në lidhje me përmbajtjen e vlerësimit të vet të rrezikut dhe të Planit SHSM të Kontratës.

Në veçanti, Kontraktori do të japë prova, nëpërmjet çertifikatave të trajnimit, regjistrimeve të trajnimit dhe vetë-deklarimit se personeli që do të përdoret për të ofruar shërbimet është kompetent, edhe në lidhje me çdo autorizim specifik të kërkuar nga ligji shqiptar.

AGSco rezervon të drejtën për veten ose për Klientin që të kërkojë në çdo kohë dëshminë e kompetencave të personelit. Nëse ndonjë person i përfshirë në dhënien e shërbimeve është gjetur se



nuk është kompetent për detyrën ose nuk është trajnuar në lidhje me kërkesat specifike të ligjit, AGS mund t'i kërkojë Kontraktori të zëvendësojë në mënyrë të detyrueshme personin me një tjetër kompetent.

### 7.3 MBETJET QË DALIN NGA KONTRAKTUESIT

Kontraktori është i vetmi përgjegjës për të gjitha mbetjet që dalin nga veprimtaritë e veta (urbane, të veçanta, të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) sipas dispozitave të ligjit shqiptar. Në veçanti, Shërbimi Kontraktori duhet të sigurojë të paktën:

- Menaxhimin;
- Karakterizimin dhe klasifikimin kur kërkohet;
- Transporti dhe dorëzimi në një impiant të përshtatshëm dhe të licencuar mbeturinash (për riciklim, ripërdorim, trajtim, asgjесim).

AGSco rezervon të drejtën për vete ose për Klientin që të kontrollojë se mbetjet e prodhuara nga Kontraktori menaxhohen në përputhje me legjislacionin aktual, duke kërkuar dokumentacionin e përkatës ose kryerjen e kontrolleve.

## 8. GARANCITË DHE DETYRIMET E KONTRAKTUESIT

Ndërhyrjet e mirëmbajtjes të përshkruara në seksionin 3, duhet të kenë një garanci prej 12 muajsh. Kontraktori do të ndërmarrë zëvendësimin ose riparimin me garanci të pjesëve që, si rezultat i operacioneve të lartpërmendura, mund të paraqesin defekte ose anomali që rezultojnë nga puna e mirëmbajtjes së kryer.

Për materialet e sapo furnizuara, garancia nuk mund të jetë më pak se 24 muaj. Kontraktori gjithashtu siguron:

- Një operim mirëmbajtje që mbulohet nga kontrata duhet të kryhet siç kërkohet nga ligji shqiptar dhe në përputhje me standardet SHSM të AGSCo dhe TAP;
- Personeli i dërguar në mjediset e TAP ka karakteristikat e raportuara në paragrafin të këtij Specifikimi Teknik;
- Konfidencialitetin e informacionit;
- Ofrimin e të gjithë dokumentacionit kontraktual;
- Aftësitë teknike të personelit dhe strukturave organizative në gjendje të operojnë edhe në panelet elektrike / elektronike të kontrollit.

Nëse zbulohen anomali në sistem të tilla si të ndikojnë në funksionimin normal të tij apo që nuk janë në përputhje me kushtet minimale të sigurisë, apo ndonjë gjë tjetër që nuk mund të garantojë efektshmërinë e përsosur të ashensorit deri në vizitën tjetër periodike, kontraktori duhet të raportojë menjëherë situatën tek AGSCo para se të kryejë riparimet e nevojshme. Çdo vonesë duhet t'i komunikohet AGSCo-s dhe të justifikohet me shkrim, përfshirë edhe me e-mail.

**Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale për të zhdëmtuar Blerësin për çdo humbje, dëmi proneje, kosto të tjera, të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë e Kontraktorit gjatë kryerjes së shërbimeve në vlerën prej 100.000 euro.**

*Ky sigurim përfshihet në piken 6.1 të kushteve të vecanta të kontratës, pjesë të DST.*

*Meqenese paisja e cila do te mirmbahet eshte pjese e paisjeve te Trans Adriatic Pipeline dhe gjithashtu ndodhet brenda aseteve te saj, kjo kerkese eshte e detyrueshme per kontraktoret te cilet do te realizojne mirembajtjen edhe vjen si kerkese specifike e klientit te AGSco - Trans Adriatic Pipeline*

**9. ANEKSET**

Aneks 1	Planimetri teknike e ashensorit
Aneks 2	AGSco-STD-001 'AGSco SHSM Standardet minimale për kontraktorët'
Aneks 3	Raporti periodik i inspektimit

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

➤ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të marrëveshjes kuadër.

#### **2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licensën NS 3-A (Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues) për montimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve.

2.2.3 OE duhet të disponojë në personelin e tij minimalisht 2 punonjës të kualifikuar për mirëmbajtjen e ashensorit:

- a) Punonjesi duhet të disponojë dëshmi për sigurimin teknik në instalimet/pajisjet elektrike.
- b) Punonjesi duhet të disponojë dëshmi /certifikate për kualifikimi për teknik ashensori.

Për të plotësuar këtë kriter OE duhet të paraqesë listepagesat e muajit Mars-Prill 2023 dhe certifikata/dëshmi kualifikimi nga një organ i akredituar në përputhje me VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik “Për Sigurinë e ashensorëve në përdorim” i ndryshuar.

Kriteret konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër (listepagesat, certifikatat/ dëshmitë) do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (Ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT).

**Bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe në formularin e kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit Shtojca 7 e DT, fituesi duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit dokumentat e specifikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “j” si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	----- -----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et


**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
